

# Etika për fëmijë

Dhuratë e përmuajshme, nga revista "Etika"

Viti I Numri 10 - Tetor 2011

Të jesh mik i mjedisit  
është virtyt!  
Eja, fitoje edhe ti!..





# Pastërtia buron nga besimi

Emine Tashgetiren



Të dashur fëmijë,  
Paqja, mëshira dhe begatia e Allahut qoftë mbi ju!

A ju ka ndodhur të shihni shiun që nga dritarja? Të duket sikur e gjithë natyra është duke u larë.

“Eja tek unë, eja tek unë”, - të duket sikur thotë çdo qenie e natyrës.

Tani ajri është shumë i pastër... Çdo gjë shkëlqen dhe qesh...

Era..! Besoj se e keni parë atë tek fryn. E kush mund t’i thotë jo asaj, që fryn ëmbëlsisht e na le dhaton këndshëm fytyrën dhe shpirtin.

A ju ka ndodhur të vështroni peshqit në akuarium? Ngjan si një maket i vogël i detit. Në të ka peshq të shumëllojshëm. Madje ka edhe një peshk, i cili mbledh mbeturinat dhe mban vendin e pastër. Më duket sikur e dëgjoj zërin e këtij peshku, që thotë përherë: “Bëhu i pastër! Nuk mund të shoh mbeturina! Bëhu i pastër...”

Toka ...një tjetër urtësi, një mirësi krejtësisht e veçantë... Ajo pranon në gjirin e saj çfarëdo të hidhet mbi të. Pas një farë kohe vihet re çuditshëm se, e gjithë ajo papastërti, ato mbeturina kthehen në një pjesë toke dheu.

Nuk ka njeri të mos ketë dëgjuar për peshkaqenin. A keni dëgjuar se peshkaqenët nuk flenë aspak dhe, se nuk mund të rrinë pa lëvizur qoftë edhe një orë? Çfarë bën vallë peshkaqeni? Është detyrë e tij të kollofitë menjëherë një peshk të ngordhur në mes të detit... Është ky peshk që kilometra larg të jetë, e ndjen erën e gjakut të peshkut të ngordhur... Pra, peshkaqeni mban të pastër detin dhe u jep mundësi qenieve të tjera të jetojnë të shëndetshme.

Shiu, toka, era dhe peshqit janë krijuar në këtë mënyrë dhe ju, tashmë i mësuat detyrat që ata kanë...

Po, prej kujt vallë? Natyrisht nga Krijuesi i gjithësisë...

Ua tregova këto të dashur fëmijë, që t’i thërrasim pakëz vetes...

Çfarë vëmë re, kur shohim perandorin e kësaj gjithësie: NJERIUN? Njeriu është qenia më e përsosur e kësaj gjithësie. Ai duhet

të shfaqë sjellje të mira dhe të rregullta. Ai duhet të bëjë përpjekje që të fitojë e mira ndaj së keqes, e drejta ndaj së padrejtës. Për çdo punë që bën duhet të mendojë se, përse e bën dhe ç’rezultat do të ketë. Ndërsa, toka, era, shiu, peshku... etj., nuk mund ta bëjnë këtë që bën njeriu. Ata janë krijuar dhe ju, i mësuat detyrat e tyre në këtë botë. Ata janë të detyruar të veprojnë ashtu, kurse njeriu si qenia më e përsosur është pajisur me cilësitë më të larta, ka vetëdije dhe është i pajisur me mendje njerëzore.

Njeriu shikon në tokë ca lëvozhga arre të hedhura. Një makinë ecën duke lënë mënjanë letra, shishe plastike dhe mbeturina...

Është vetëm njeriu që mendon dhe vepron se këto lëvozhga arre, letra, shishe plastike, lëkura frutash e mbeturina të tjera, duhen vendosur në vende të caktuara, që gjithëherë mjedisi të jetë i pastër dhe i shëndetshëm. Dhe e bën ai njeri që është i pajisur me mirësi dhe mban në zemër mësimet dhe urtësitë e Krijuesit, sepse Pastërtia buron nga besimi. Besimtarët janë ata njerëz nga dora dhe gjuha e të cilëve nuk ka dëm asnjë gjallesë. Kështu, toka mbetet e kënaqur, lulet kënaqen, po kështu frutat dhe mirësitë e tjera dhe çdo gjë fiton vlerën që meriton... E gjithë natyra qesh, dritësohet kur i shërben një njeriu që mendon, vepron, falënderon dhe adhuron...

Çfarë ndodh po të veprohet ndryshe?! Një gotë e thyer, e lënë në piknik, bëhet shkak për gjymtimin e dikujt, një zjarr i vogël i lënë pa kujdes i hap rrugë ndezjes së një pem e më vonë të një pylli.

Pra, besimtari duhet të jetë i dobishëm për çdo qenie. Të gjitha krijesat gëzohen e shëndohen me të. Krijuesi i gjithësisë dëshiron që njeriu të dijë se, përse janë krijuar të gjitha këto qenie dhe për kë janë krijuar. Ai kërkon që njeriu t’i përdorë në vendin e duhur dhe të jetë në shërbim të tyre.

Ndaj dhe ju, të dashur fëmijë duhet të jeni she mbull i së drejtës, i së mirës, i së bukurës..., sepse juve nuk ju shkon tjetër gjë veç të jeni miq të ngushtë e të pandarë të sjelljeve të mira.



*Xhevat Beqaraj*

# *Tetori*

Në pyll udhët më s'na ftojnë  
Për kërpudha, manaferra...

Po me ketrit lodërtarë  
Boçe vjelim nëpër bredha.

Nëpër retë vetullzeza  
Syri i vetëtimës ndriu.  
Si fëmijët akulloret,  
Trotuaret lëpin shiu.

**Etika për femrë**

Viti | Numri: 10 - Tetor 2011

Drejtor  
& Kryeredaktor:  
**Alban Kali**  
albankali@yahoo.com  
+355 69 24 23 989

Redaktor:  
**Xhahid Bushati**  
xhahidbushati@yahoo.com  
+355 69 28 20 975

Redaktore gjuhësore:  
**Ma. Irida Hoti**

Dizajn - Grafik:  
**Bledar Xama**  
bledar\_xama@hotmail.com

**Adresa:** L: Vasil Shanto - Rr: Çajupi - Shkodër - Albania / Tel: +355 22 254 634 / Fax: +355 22 254 633  
**Zyra e përfaqësimit Maqedoni:** Rr: Stiv Naumov - Nr. 9 - lokal 25 - Shkup - Maqedoni / Tel: +389 71 956 271  
**Zyra e përfaqësimit Kosovë:** Rr: Ardian Zurnaxhiu - pn. Ralin - Prizren - Kosovë / Tel: +381 29 222 795



# Përralla e Gjethes së vogël

Në një agim të bukur pranvere, në pyllin e moçëm çeli një gjethe e vogël.

Fëshfërinte e ndrojtur. Rrinte e fshehur mes gjetheve. Nganjëherë, ngrinte kokën gjelbëroshe dhe vështronte përreth. Nuk i vinte mirë që, gjethet që i kishte pranë, ishin më të mëdha në moshë se ajo. Brengën e saj nuk ia shprehte dot askujt, sepse ende nuk kishte zënë shoqe.

Dielli po perëndonte, kur një gjethe iu afrua gjelbëroshe të sapoçelur e i tha: “Një ditë do ta ndjesh veten të rritur edhe ti!”.

Gjethja e vogël ktheu kokën për ta njohur bashkëfolësen, por nuk arriti ta dallojë atë mes gjetheve. Ndjeu një gëzim të brendshëm, u qetësua dhe fëshfëriti e gëzuar fësh-fësh-fësh..!

Kaluan ditë, por gjethen e vogël nisi ta brejë, përsëri, mendimi: “U bënë tre ditë që kam çelur, dhe askush nuk kujtohet për mua. Veç në të rrallë vjen Flladi i Pranverës. Edhe ai, vjen herët në agim e më zgjon nga gjumi. Pastaj ikën dhe kujtohet të vijë në muzg, kur bëhem gati të fle. E, në këtë orë të muzgut, Flladi bisedon shkurt, kur unë dua të bisedoj gjatë...”

Gjethja nisi të mërzitej për vetminë e saj...

Një ditë në pyll erdhi shiu i pranverës. E, shirat e pranverës, zakonisht, janë të shkurtër.

Në pyll ranë mijëra pika shiu. Një pikë shiu, si një balerinë, vrapoi e kërceu mbi të voglën gjethe. Kur u lodh, pushoi mbi të.

- Cila jeni ju?! – pyeti gjethja e vogël.

- Një pikë e vogël shiu që më solli Shiu i Pranverës.

- Qan, ti pikë e shiut? – pyeti gjethja e vogël.

- Unë..?! Mos vallë të dukem si pikë loti?!..

- Nuk e di, por... faqeve të mija rrjedhin shumë pika ... Nuk më ka ndodhur ndonjë herë...

- Ha, ha, ha! – qeshi pika e shiut. Unë jam një pikë pastërtore.

Pika e shiut nuk foli më, se në qiell doli papritur dielli, dhe ishte një diell i qeshur. Rrezet e tij erdhën dhe në pyllin e gjelbër, edhe atje, ku jetonte gjethja e vogël, që mendonte se e kishin harruar...

Gjelbëroshja mori ngjyrën e rrezeve të arta. Ajo nuk mund ta shikonte veten se ç'nur i bukur i kish rënë, se lumi ishte larg dhe nuk mund të shikohej në pasqyrën e tij.

Gjethja e vogël dëgjoi një rreze që u tha shoqeve:

- Dua t'ju njoh me një gjethe, që rrobat i mban të pastra e nuk i ndot.

- Uaaa, sa gjethe e bukur! Qenka si dritë! – thanë njëzëri rrezet flokarta.

- O rreze, mos e njihni një pikë të vogël shiu, që pak më parë ishte mysafire në shtëpizën time? – pyeti gjethja.

- Po, - foli një rreze. E takova në shtëpizën e gjelbër të një gjetheje.

- Ajo më gjelbëroi, ndërsa, ju më dhatë dritë, - tha gjethja.

- Ne dhurojmë dritë, por dhe marrim dritë, si sot nga gjelbërimi yt, - tha rrezja dhe u bashku me shoqet flokarta.

Gjethja e vogël vështroi ylberin e dritës dhe e kuptoi se ishte rritur! Kishte lënë pas fëmijërinë dhe i gëzohej pranverës...

# Paraja

Ishte ditë Ramazani.

Ethemi, pak para se të afronte iftari, shkoi në furrë për të marrë byrekun. Përpara furrës ishte një radhë e gjatë. Kur u afrua koha e iftarit, njerëzit që prisnin në radhë, filluan të mos duronin më. Furrxhiu ishte edhe më i shqetësuar. Nuk ishte e lehtë t'u jepje byrekët atyre që u vinte radha dhe t'u merrje paratë.

Pak para se të binte daullja e iftarit, i erdhi radha Ethemit. Furrxhiu ishte tepër i lodhur dhe gabimisht i ktheu më shumë kusur.

Ethemi ndaloj një çast dhe e pa me habi furrxhiun. Burri e pyeti:

- Mos ndodhi ndonjë gabim, bir?

Ethemi u përgjigj:

- Jo xhaxha!

Mori paratë dhe shkoi në shtëpi duke vrapuar.

Në tryezën e iftarit, Ethemi kishte humbur në mendime. Kur hyri në shtrat, shqetësimi iu shtua edhe më shumë. Sikur një njeri i padukshëm po i kërkonte llogari dhe i thoshte:

“Pse e bëre këtë? Përse i more paratë, të cilat nuk ishin të tuat?”

Ai mendoi t'ia tregonte nënës së tij ato që kishin ndodhur. Pastaj menjëherë hoqi dorë. Me siguri nëna do ta qortonte dhe do të zemërohej shumë.

Gjatë natës pa ëndrra të frikshme. Kur u zgjua në mëngjes, ishte edhe më i shqetësuar dhe diçka e mundonte në zemër. Këputi fletën e kalendarit dhe filloi ta lexonte. Aty shkruhej ky hadith fisnik i Pejgamberit tonë (a.s.):

**“Mëkati është ajo gjë që ta bren zemrën dhe nuk dëshiron që ta dinë të tjerët.”** (Muslim, Birr, 14-15)

Ethemi ndjeu se iu skuq fytyra. Sikur këtë hadith Pejgamberi ynë i Nderuar e kishte shkruar tamam për të. Shkoi drejt e te furra. Paratë, të cilat nuk ishin të tijat, ia dorëzoi furrxhiut duke i kërkuar ndjesë.



# Ndërmjetësi

Ishte një ditë e ftohtë dimri. Isai po shkonte në shkollë. Rrugës takoi një fëmijë të varfër. Ai nuk kishte pallto që të mbrohej nga i ftohti. Ai kishte një palë këpucë të grisura që i fusnin ujë. Isai ndjeu se po i dridhej zemra. Familja e tij nuk ishte shumë e pasur, por jetonin pa ia pasur nevojën askujt.

Ai filloi ta ndiqte fëmijën e varfër. U habit kur pa se ai hyri në shkollën e tij. Nuk po i kujtohej ta kishte parë ndonjëherë më parë. Mendoi se çfarë duhej të bënte për ta ndihmuar, por nuk gjeti ndonjë mënyrë. Nëse ia falte këpucët me qafa të gjata të cilat i kishte përdorur që prej dy vjetësh, ai nuk kishte çfarë të vishte në vend të tyre. Po si t'ia bënte?.. Nisi të mendohej...

Në pushimin e drekës e gjeti fëmijën e varfër në oborrin e shkollës. I tha atij se dëshironte të bëhej shok me të dhe menjëherë u miqësuan. Djali i tregoi se babai i kishte vdekur para disa vitesh. Tani jetonte me nënën dhe dy vëllezërit e tij më të vegjël. Në këtë lagje sapo kishin ardhur. Ndësa bisedonin, i hëngrën bashkë biskotat që kishte Isai në çantë.

Në mbrëmje Isai i tha babait:

- Mësuesi na ka dhënë një detyrë me temë: "Si mund të ndihmojmë të varfërit."

Babai i dha disa këshilla se si mund t'i ndihmonte ata.

Të nesërmen, kur Isai doli nga shkolla, shkoi drejt e te shoqata e ndihmës për të varfërit. Takoi një burrë, në sytë e të cilit shfaqej mirësia. I tregoi gjendjen e shokut të tij. I lut që ta ndihmonte. Njeriu zemërmirë e pëlqeu shumë sjelljen e Isait dhe e përgëzoi atë. Pasi e pyeti, se ku banonte shoku i tij, i tha:

- Njerëzit si ti i do Allahu dhe i Dërguari i Tij, sepse ti ke vepruar sipas këtij hadithi të Pejgamberit tonë (a.s.):

**"Ai që ndërmjetëson për tu bërë një punë e mirë, fiton sevape sikur ta kishte bërë vetë atë."** (Tirmidhi, Ilim, 14)



# Unë të besoj, o i Dërguari i Allahut

Xhandeger Tetik

Qabeja është vend i shenjtë. Ajo është ndërtuar nga Hazreti Ademi dhe e restauruar nga Hazreti Ibrahim.

Meka është vendi i shenjtë që nga koha e njeriut dhe profetit të parë. Këtu janë ngritur panairë të ndryshme, pasi ishte vend i begatë. Në këtë qytet vinin karvanet nga shtetet fqinje dhe qytetet e tjera.

Në një nga lagjet e Mekës ndodhi kjo ngjarje...

Një pasdite kur fëmijët po përfundonin lojën e tyre dhe zogjtë po iknin një nga një në çerdhe, papritur një fëmijë dhe ky ishte Enesi, u nda nga grupi i bashkëmoshatarëve. Në vend që të shkonte në shtëpi, u nis drejt tregut. Kur mbërriti pranë kodrës Safa, vuri re se një grup njerëzish, të cilët rrethonin një njeri.

"Diçka paska ndodhur...", - mendoi me vete Enesi dhe kureshtja e ftoi t'i drejtohej turmës.

Me t'u afruar, dalloi një njeri. Ai po ligjëronte para njerëzve.

**"Po, ky është Muhamedi, i Besueshmi! Çfarë thotë vallë?.."** - mendoi përsëri me vete.

Enesi u afrua dhe dëgjoi më qartë fjalët e Tij.

**- O populli Kurejsh! Nëse u them se pas këtij mali keni armiqtë tuaj që do t'iu sulmojnë dhe do t'iu grabisin mallrat, a do të më besoni?..**

Të gjithë njëzëri bashkë me Enesin thanë:



- Të besojmë! Deri tani, nuk na ke gënjyer. Ti je njeri i sigurtë! Ti je më i besueshmi dhe më i rregullti ndër ne!

**- Atëherë unë po ju them se, mua më ka dërguar Allahu i Lartmadhëruar për t'ju udhëzuar në rrugën e drejtë.**

Papritur ra heshtja. Të gjithë shihnin njëri-tjetrin të habitur. Kishin marrë një ftesë të papritur...

Heshtjen e theu Ebu Lehebi, xhaxhai i Muhamedit (a.s.), i cili përdori fjalë të rënda e të pahijshme kundër nipit të tij.

Pas këtij qëndrimi të ashpër të Ebu Lehebit, njerëzit nisën të shpërndaheshin, të pavendosur dhe të habitur. Sikur s'po kuptonin asgjë. Vështrojnë Ebu Lehebin, i cili ngjante i vetmuar.

Muhamedi (a.s.), zbriti nga kodra Safa dhe i hodhi një shikim dashamirës Enesit që kishte mbetur i çuditur dhe kishte rënë në mendime të thella.

Ai nuk ia ndante vështrimin Muhamedit (a.s.), dhe nga zemra i dolën këto fjalë:

**- Unë të besoj, o i Dërguari i Allahut!..**



# Allahu na sheh...

Ishte mbrëmje. Omeri (r.a.) po ecte si përherë nëpër rrugët e Medinës. Për një çast ndaloi. Ishte përballë një shtëpie, ku dëgjoheshin zërat e një nëne dhe së bijës. Ata diskutonin me zë të lartë.

E ëma i thoshte së bijës:

- Bija ime, hidhi ujë qumështit, që do shesim nesër.
- Nënë, a nuk e ndaloi halifja, t'i hedhim qumështit, ujë? - ia ktheu e bija.
- Ku do e marrë vesh halifja në këtë orë të vonë të natës se i kemi hedhur qumështit ujë? - i tha e ëma së bijës.

Vajza e re, shpirti i së cilës qe mbushur me dashurinë për Allahun, nuk e pranoi veprimin e së ëmës për t'i hedhur ujë qumështit.

- Nënë, le ta pranojmë se halifja nuk sheh, po ti mendon se as Allahu nuk sheh?.. Është e lehtë ta fshehësh këtë veprim prej njerëzve, po si mundet t'ia fshehësh para Allahut që sheh dhe dëgjon çdo gjë?..

Halifi Omer, e dëgjoi këtë bisedë dhe i ndikuar nga dashuria e vajzës për Allahun, e martoi atë me të birin e tij, Asim.

Omer bin Abdulaziz, i njohur për drejtësinë e tij, është nipi i vajzës së historisë së qumështit, zemra e së cilës qe mbushur me dashurinë për Allahun.



# Nastradin Hoxha

Pa shiko këtë brumbull plehu! Sa e çuditshme!

O Allah! Përse e ke krijuar këtë krijesë të panevojshme?

Të nesërmen

Po më kruhet i gjithë trupi.

Më duhet të shkoj tek doktori.

Nastradin efendi! Nëse do të shërohesh, duhet të përtpypësh

pesë brumbuj plehu.

Një javë më pas

Nastradin efendi!  
Vallë pse e ka krijuar Allahu milingonën?

Të lutem, o komshi, mos i fut hundët në punët e Allahut. Unë i futa dhe mu desh të ha pesë brumbuj plehu. Prandaj mos na bëj të hamë edhe këtë krijesë. Allahu e di më së miri...

# Të kujdesesh për Allahun



Në mëngjes po kontrollonte llogaritë e muajt në dyqanin e tij. Kishte shumë fatura për të paguar. Ec e dil në krye kësaj pune, tani. Në atë moment në dyqan hyn një grua.



Biri im! Siç e shikon jam shumë e moshuar. Por më e keqja është se jam shumë e sëmurë. Nuk kam para për të blerë ilaçet. A më ndihmon që t'i marr ilaçet, mor bir?



Ec, m'g nënë! Ne sjemi baballarët e të varfërve. Paratë na duhen edhe neve?



Pak më vonë në dyqan hyn një gjale i vogël. Duket se ishte shumë i uritur.



Xhaxhi! Jam shumë i uritur. A po më jep ndojë gjë për të ngrënë ose ca para për bukë?



Nëse i jap para për bukë çdo kush që më vjen, a do më ngelet para për vete, more picirruk? Hë t'ec... Allahu të dhëntë!



Po, mor xhaxha sevap është, por një shishe ujë bën 50 lekë. Më jep paratë dhe të jap një shishe ujë për sevap.



Më vonë erdhi një burrë i moshuar dhe i kërkoi ujë.

Biri im! A po më jep ndojë shishe ujë të ftohtë për hir të Zotit. U thava nga eja. Është sevap, mor bir!

Edhe ditën e sotme e kishte mbyllur me fitim. Si gjithmonë hëngri ushqim në restorant dhe, pasi mbushi barkun shkoi drjt e në shtëpi.



U shtri në krevatin e tij të butë dhe e zuri gjumi me një ëherë.



Atë natë pa një ëndërr sikur ishte bërë kiameti. Një erëziti ishin mbledhur në sheshin e "Mahsherit". Kur i erdhi radha për të dhënë llogari, e zuri një frikë e madhe dhe filloi të dridhëj i tëri.



Allahu i foli:




"Unë të kisha dhënë aq shumë të mira, por kur të kërkova një gotë një nuk ma dhe."

"O Zot! Po si mund të të jap një Ty, kur Ty nuk të kaplon eja?"




"Një robin Tim e kishte marrë eja dhe kërkoi një për tëje. Nëse do t'i jepje një atj, do të ishte sikur të më kishe dhënë Mua. Unë të dhashë edhe shëndet të mirë, por ti nuk më ndihmove, kur Unë isha sëmurë!"



E si mund të të ndihmojë unë Ty, o Zot!? Ti nuk sëmuresh asnjëherë!



"Një robi Im ishte sëmurë dhe kërkoi ndihmë për tëje. Nëse do ta kishe ndihmuar atë, do të ishte sikur të më kishe ndihmuar edhe Mua."



"Ti je një rjeri shumë koprrac. Unë të kisha furnizuar me shumë të mira, por ti nuk më dhe qoftë edhe një kafshatë bukë, kur Unë isha i uritur."



"Si është e mundur o Zot!? Ti je Zoti i botëve! Ty nuk të merr uria kurrë!"

"Një robin Tim e kishte marrë uria dhe kërkoi disa kafshata bukë për tëje. Nëse do t'i kishe dhënë ushqim atj, do të ishte sikur të më kishe dhënë edhe Mua. Megjithatë të kisha dhënë gjithë ato të mira, ti u tregove mosmirëj ohës. Tani do të vuash për mosmirëj oj en tende."



"O Zot! Të lutem më jep edhe një mundësi jetësh dhe do të shikosh se sa mirësi do t'u bëj roberve të Tu! Të gjithë pasurinë time do ta harxhoj në rrugën Tëndë!"



Kur melekët ndëshkues e kapen fort për kraresh për ta marrë, ai u zgjua duke qarë dhe duke u lutur me denesë.



"Të lutem o Zot! Më jep edhe një mundësi!"

Ai u zgjua nga një ëndërr e keqe. Atj, tashmë, i ishte dhënë mundësia e asaj që kerkonte.

Adelina R. Mamaqi



# PËRRALLËZA E SHKRONJËS



## HARABELAT QË I ZURI NATA

Na ishte njëherë një harabel i vogël, me emrin Habi, që ishte çelur nga një vezë e vogël, në një folezë të vogël, ku jetonte me mamin. Vogëlushit po i rriteshin e i forcoheshin krahët. Ai filloi të hidhej nëpër fole, pastaj rreth e qark degëzave të pemës gjersa mori guximin të shkonte te pema më e afërt.

Një padite iu mbush mendja të fluturonte në hapësirën e qiellit...Ah, sa i lumtur ndihej! Por, befas, krahëzat e vegjël iu lodhën dhe u lëshua mbi një degëz peme. Atë çast dëgjoji një cicërimë:

- Cërr...cërr...cërr...u vrave? - i tha një harabel vogëlush, si ai.

- Jo, nuk u vrava. Të faleminderit.

- Si e ke emrin?

- Harabeli Heli. Po ti?

- Harabeli Habi.

- Qenkemi kushërinj.

- E, pra, sa qejf!... A bëhemi shokë?

- Po si jo?... A lozim "e ka kush e ka"?

Kështu filluan të ndjekin njeri-tjetrin dhe harruan të ktheheshin në foletë e tyre. Madje, shkuan aq larg, sa humbën rrugën. Po perëndonte dielli dhe po fillonte të errej. U ndalën te një tel telefoni:

- Po tani si do të kthehemi? - pyeti me zë të hollë harabeli Habi.

- Po sikur të na hajë skifteri? - ia bëri duke u dridhur harabeli Heli.

- Unë e vras skifterin! - u mburr harabeli Habi - Mbështete kryet te krahu im e mos u tremb fare!

Kështu, Habin dhe Helin i zuri gjumi. Po mamatë e tyre a mund të flinin dot? Ato nuk lanë vend pa i kërkuar. Të hidhëruara, filluan të klithin me të madhe. Hëna, që po hidhte valle plot hare në mes yjeve, befas u ndal, hodhi rrezet gjer te mamatë e hidhëruara dhe u tregoi ku po flinin vogëlushet e tyre. Ato nuk harruan të falënderonin hënë dhe u turrën te harabelat e vegjël. I kapën me sqep dhe i çuan secilin në fole të vet.

Harabelat nuk u zgjuan fare.

Ata flinin dhe shikonin ëndrra me telefon...cërr...cërr...cërr... Sa bukur qenka të fliturosh!...Hëna buzëqeshi dhe vazhdoi vallen e saj të përnatshme...





# Lapsi i dëshiravë

Ishte shtator...

Elsari po përgatitej për të hyrë në klasën e parë. Së bashku me mamin shkuan për të blerë mjetet shkollore. Ishte i emocionuar, se po fillonte shkollën për herë të parë. I pëlqente..., por ende nuk e dinte se ç' rezultate do të kishte në mësim. Ama, e dinte se kjo ishte një rrugë e gjatë...

Mes mjeteve të shumta, ai bleu edhe një laps të veçantë me ngjyra-ngjyra: të verdhë, gri, rozë, të zi... Lapsi ishte i trashë, i gjatë dhe zbukurohej me figura të çuditshme...

Shkollat filluan. Elsari i bëri detyrat me kujdes. Mësuesja e lavdëroi dhe i tha:

- Të lumtë, Elsar! I ke bërë më bukur e më mirë se të tjerët! Merrni shembull nga Elsari!

Elsari u gëzua, dhe mendoi njëherësh se, këtë meritë ia jepte lapsi. Por... lapsi nga dita në ditë bëhej edhe më i vogël... Elsari nisi të mërziej. Mendonte përsëri se, nuk do i bënte detyrat si më parë: bukur e me kujdes.

Një ditë lapsi u zvogëlua aq shumë sa nuk mund të shkruhej më me të. Elsari u zemërua dhe u bë tekanj. Donte po atë laps, megjithëse kishte plot lapsa të tjerë. Këmbëngulte të shkonte me mamin te po e njëjta kancelari e të gjente lapsin e tij të veçantë. Mami, më në fund, ia plotësoi dëshirën. Kur shkuan te shitësi, Elsari ia përshkroi lapsin me të gjitha detajet. Shitësi, i prekur nga tregimi i djalit, i tha me keqardhje:

- Nga lapsi që kërkon, kam pasur vetëm një kuti. Më vjen keq... janë ishin shitur të gjitha.

Elsari shkoi në shtëpi i trishtuar. Të nesërmen i erdhi një mendim, të shkonte te dyqani dhe ta pyeste shitësin se kur i vinte furnizimi. Dhe kështu bëri. Shitësi i premtoi që do t'ia sillte të dielën. Elsarit nuk i pritej, mendjen e kishte vetëm tek lapsi, e ndërkohë rezultatet sa vinin e bëheshin më të dobëta.

Të dielën në mëngjes, me të rënë ora tetë, Elsari vrapoi për te dyqani. Shitësi e kishte mbajtur premtimin dhe para syve të Elsarit vendosi një kuti të madhe me lapsa si ajo e dëshirave të tij.

Ai shkoi me nxitim në shtëpi dhe nisi të bënte mësimet. Kur erdhi radha e detyrave, lapsi sikur... nuk po ia plotësonte dëshirën... Nuk ishte i shpejtë si në ditët e para të shkollës. Sikur ta dinte edhe lapsi se, Elsari kishte krijuar mangësi në detyrat e mëparshme, nuk kishte punuar me rregull e në mënyrë sistematike. Kështu që, orët kalonin dhe lapsi lëvizte ngadalë e ngadalë.

Elsari i mërziur e pyeti:

-Mos je dembel?!.. Vëllai yt ishte më i shkathët, më i shpejtë... Ç'ka ndodhur me ty?!

Lapsi diç shkroi në fletore... Elsari nisi të lexojë: "Nuk jam unë, LAPSI, që të bëj të jesh më i miri! Gabohesh, Elsar! Është dëshira dhe vullneti për të punuar. Këto mos i harro kurrë!"

Elsari vështroi lapsin dhe pa se po ecte më shpejt. Diçka kishte filluar të ndryshonte për mirë te vetja e tij. Këtë e ndiente dhe vetë Elsari.

# Të njohim miqtë tanë, kafshët



Ada Mara

## LARASKA

Sytë hap me krrak-krrak-krraake.

Zhurmarake, mburracake.

Llafazane e dinake,

Por, më keq! Dhe vjedhacake!

Çfarë sheh, me sqep e ngre

Dhe e shpije në fole.

Atje gjejmë plot stolira,  
Që rrëmben nëpër shtëpira.

I rrëmben, por kurrë s'i vë,

Se, ato nuk bëjnë për të!







# HIPOPOTAMI

I shëmtuar thonë, jam,  
Më quajnë hipopotam.

Jam i rëndë dhe i madh,  
Rroj në ujë, si në livadh.

Me të veckëlit e mi,  
Jam i dashur, si njeri.

Dukem si një kafshë e qetë,  
Vetëm... ruaju se më nget!





# MENDO PAK... E BUZËQESH

## Ku është fshehur boça e pishës



Vjeshta erdhi në pyll. Erdhi e zemëruar.

- Vu-vu-vuuu! Vu-vu-vuuu...!

Pylli dridhej. Dridheshin edhe halat e pishave.

Era, gjatë vrapit të saj, u bë më zemërake. Zgjati dorën e padukshme dhe tak, këputi një boçe të vogël nga një pishë sygjelbër. Pisha ndjeu dhembje. Sytë iu mbushën me lot të gjelbër. Nga që ishin të shumtë, rrodhën pikë-pikë e ranë mbi faqet e ketrushit Stik, i cili kishte shtëpizën te kjo pishë sygjelbër.

Ketrushi pyeti i çuditur:

- U bëra dy vjeç dhe s'më ka qëlluar të shoh shi të gjelbër!? Ç'të ka ndodhur, moj pishë e vogël?! Përse qan?!

- Stik i vogël, ç'të them... - Era më rrëmbeu një nga boçat e vogla dhe ma degdisi larg, shumë larg... E kam rritur me njëmijë e një mundime! Më bëhet sikur dëgjoj ende zërin e saj. Kërkon ndihmë, e vogla e nënës! Ç'të bëj unë, e gjelbra? Rrënjët e mia janë ngulur thellë në tokë e s'mund të lëvizin. Më duket, o ketër se, e humba përgjithmonë gjelbëroshten time!

- Mos u mërzit pishë e gjelbër! Të premtoj se do ta gjej unë, - tha Stiku.

Fjalët e ketrushit ngrohën zemrën e pishës sygjelbër.

Stiku zbriti si ketër nga pema. Kri-kri-kri, mori udhën për të gjetur boçën e pishës.

Kri-kri-kri, ec e ec...

Në anë të një udhe takoi një degëz me gjethe. E pyeti:

- Mos keni parë një boçe të vogël pishë? Ajo humbi sot...

- Ua, sikur nuk shikon, o ketër, se ç'bëhet në pyll?! - tha një gjethe sa një këmbë pate. - Unë mezi flas, se dridhem nga zemërimi i erës, ti pyet për një boçe të vogël pishë...

- Mos u zemëro, o gjethe, edhe ti si era, - ia priti Stiku.

- Po ti, pyet ketrush!..., - ndërhyri një gjethe gjysmë e verdhë. - Boçat e pishës nuk ikin pa lënë adresë...?!

- Jo, atë e rrëmbeu papritur era shamatare, - tha Stiku dhe vazhdoi udhën...

- Ha-ha-haaa! - qeshi era që dëgjoji bisedën e Stikut me gjethe gjysmë të verdhë. - Mos u mundo,

o ketër i vogël se, nuk e gjen dot! - tha era dhe iku ashtu siç erdhi: vu-vu-vuuu, zemërake dhe e ftohtë.

- Erë, moj erë, boçën e vogël e pret nëna Pishë. -

Sikur... s'të takon ty!.. - tha ketri këmbëngulës.

- Ashtu është, e vër... tetë..., - nisi të tallej era që erdhi përsëri.

- Atëherë, ma jep!.. - tha Stiku serioz.

- Ha-ha-ha! Ha-hahaaa! - qeshi përsëri era.

- S'ka asgjë për të qeshur, - foli Stiku i çuditur.

Unë i kam dhënë fjalën Pishës sygjelbër, se do t'ia gjej boçën e vogël, dhe do t'ia gjej...

- E çfarë pastaj...?!

- Jam një ketër i vendosur. - Dhe ti, erë, sa të duash zemërohu, inatosu; por unë do ta gjej se ku e ke fshehur boçën e pishës! Do ta gjej patjetër...

- Vërtet?!

- Po.

- Vu-vu-vu, do ta shoh zgjuarsinë tënde, o ketër...

Era, vu-vu-vu, vinte; era, vu-vu-vu, ikte...

Kur ajo nisi të zbutej, të bëhej më e ngrohtë, papritur i tha Stikut:

"Kësaj here, me ty ketër, po tregohem zemërmirë. Po të ndihmoj, ngaqë je i vogël. Më dëgjo me kujdes: *Nuk po të tregoj se ku e kam fshehur boçën e pishës. Mundohu ta gjeshe vetë, ndryshe do ta humbasësh përgjithmonë atë. Boçën e pishës e kam fshehur në njërin nga këto vende:*

**O te gëmusha e iriq Gjembaçit, o te kërpu-dha Kuqlore?,**

**O te zgavra e lisit të moçëm, o te strofka e lepurushit matanë shtegut të lajthive?... Gjeje, se ku?.. Ta shohim zgjuarsinë tënde...**

Kujdes, ketrush! Mirupafshin, Stik! Unë po vazhdoj udhëtimin tim stinor, ndërsa ti, vazhdo udhëtimin në gjetjen e boçës së vogël të pishës. Vu-vu-vu, vu-vu-vuuu..."

Edhe ju, vogëlushë mos përtoni e mos rrini indiferentë, po ndihmojeni ketrin e vogël Stik që ta gjejë sa më parë boçën e pishës!

Po të gjendet boça e vogël, Pisha sygjelbër do t'i pushojë lotët.

Po të gjendet boça e vogël, Era e vjeshtës nuk do të jetë shamatare, e nuk do të qeshë kot së koti.

Po të gjendet boça e vogël, ketri Stik do të fitojë... (e dini vetë, se çfarë premtoi ai...).

**Përgjigje:**

Boça e pishës është e fshehur pas kërpuhdhës Kuqlore.





# NGJYROS





Njëra nga fotot  
e vogla duhet  
vendosur në  
vendin e duhur.  
Gjejini atë?..



A



B



C




D



E



F



Genti do të luajë me Albanin.  
Ndhmoheni të gjejë rrugën  
dhe të shkojë tek ai.



# GJENI 7 NDRYSHIMET



Ndihmojeni Ahmetin të gjejë shokët e tij, pa rënë në kthetrat e tigrin.

A dëshironi ta përfundoni ushtrimin e mëposhtëm? Mos harro se çdo simbol është në vend të një numri.



1	♥	3	☀
+	6	★	☀
=	★	9	8
			★





# GAZMORE



DOKTORI MË THA: 'JE SHUMË I DOBËT, DUHET TË MARRËSH CA KILE'.



AAA!..  
ORË RËRE!..



SI MA MBYLLI  
TELEFONIN NË  
FYTYRË!..



PYETJET ISHIN TË LEHTA, POR  
PËRGJIGJET ISHIN  
SHUMË TË VËSHTRIRA.



Ah, o dyqanxhi.  
Më dhemb çdo vend  
i trupit.

E ke nga pleqëria,  
o xaxha...



Do të jepja njëqind  
miliardë për të qenë  
në moshën tënde.

Ouuu! Ti nuk po më jep dy  
qindarkat që më ke borxh, nga  
do t'i gjesh njëqind miliardë?



Eh, more, Syzi,  
tashmë jeta është  
bërë shumë e  
vështirë.

Po pse, more Bedri, e ke të vështirë?..  
Ti, veç rrihe ndonjë  
dhe i merr paratë.



Mirë e ke, por asnjëri prej atyre  
që kam rrahur nuk kishte para...

*Tani  
në duart  
tuaja*

# FEJA IME E BUKUR 2




TE MËSOJMË KUSHTET E BESIMIT

PROGRESI

# 40 Hadithe

## ME TREGIME PËR FËMIJË



*“Buqetë dyzet haditbësbe”  
nga Pejgamberi ynë i dasbur...*

*Tregime të shkruara thjeshtë e qartë,  
të ilustruar me shije dhe fantazi...*

*40 histori, të rrëfyera bukur  
e me mjeshtëri të lartë artistike,  
ku shpikat fitorja e së mirës mbi të keqen,  
ku virtyti mund vesin.*



**Vetëm  
1€**

PROGRESI  
BOTIMI

[www.progresibotime.com](http://www.progresibotime.com)